

**VENDIM**  
**Nr. 1, datë 21.5.2019**

**MBI SHFUQIZIMIN E KOMPETENCAVE TË DELEGUARA ME VENDIMIN NR.**  
**244, DATË 22.12.2018, “PËR DELEGIM KOMPETENCE TË KRYETARIT**  
**TË KLSH-së”**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”:

- neni 24, pika 1 “Vazhdimësia pas përfundimit të mandatit” të kryetarit të KLSH-së;
- neni 25, “Përgjegjësitë e kryetarit”, gjerat “P” dhe “I”;
- neni 19, “Zgjedhja dhe qëndrimi në detyrë”, pika 1.

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht:

- neni 164, pika 1, sipas së cilës: “KLSH-ja paraqet në Kuvend Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit”;
- pas kërkesës për tërheqje nga kompetencat e deleguara të zv.kryetares, znj. Lindita Milo, për arsye personale, datë 21.5.2019, nr. 347, dhe garantimit të vijueshmërisë normale të punës;
- në kushtet e zgjatjes në kohë të nominimit dhe përzgjedhjes së Kryetarit të ri të KLSH-së, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014,

**VENDOSA:**

1. Shfuqizimin e kompetencave të deleguara me vendimin e kryetarit nr. 244, datë 22.12.2018 zv.kryetarit të KLSH-së znj. Lindita Lati (Milo).
2. Ky vendim do të përcillet Presidentit të Republikës, kryetarit të Kuvendit, kryetarit të opozitës.
3. Vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Bujar Leskaj**